




01-738

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/04-56362/24 dt. 30.04.2024, të pronarëve Blerton, Vullnet dhe Vigan Gashi nga fshati Dobërdol Komuna e Podujevës, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin e ndërtesave afariste, ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 03.07.2024, lëshon këtë:

C E R T I F I K A T Ë E P Ë R D O R I M I T

- I. I LEJOHET** pronarëve Blerton, Vullnet dhe Vigan Gashi nga fshati Dobërdol Komuna e Podujevës, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-56362/24 dt. 30.04.2024, përdorimi i kompleksit të ndërtesave afariste, të emërtuara si “Ndërtesa 1”, “Ndërtesa 2” dhe “Ndërtesa 3” me etazhitet P+0ET, e ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-216307/21 dt. 13.07.2022, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1559-28, ZK Prishtinë.
- II.** Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugën “Hyrije Hana” ku kanë dalje hyrjet e ketyre ndërtesave me numrat: 1, 3, 5, 7, 9, 11 dhe 13 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.
- IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Blerton, Vullnet dhe Vigan Gashi nga fshati Dobërdol Komuna e Podujevës, me kërkesën me 05 Nr.391/02-56362/24 dt. 30.04.2024, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin e ndërtesave afariste, të emërtuar si “Ndërtesa 1”, “Ndërtesa 2” dhe “Ndërtesa 3” me etazhitet P+0ET, të ndërtuara në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1559-28, ZK Prishtinë, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-216307/21 dt. 13.07.2022 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-135476/23 dt. 13.11.2023,

ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukurore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukurore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukurore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukurore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografji gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtës Edona Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Gazmend Vokshi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Edona Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Dea Hasani; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Rexhep Haliti; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Arban Shala, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Shaqir Kuçi me nr. të licencës 86;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht kompleksi i ndërtesave afariste mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuar-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat afariste mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtest afariste.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund të drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-56362/24 DT. 03.07.2024**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



